

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Per fondet e perfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Partia Ardhmëria Shqiptare
Tiranë

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Bazuar ne Ligjin Nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Për Partitë Politike Nr. 8580 datë 17/02/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374 datë 10/02/2011, ligjin nr. 17/2014 datë 20/02/2014 Ligjin nr. 25/2014, datë 25/09/2014, ligjin nr. 90/2017.

Udhëzimi Nr. 1, datë 31.05.2017, "Per perdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

Vendimi nr.740, datë 31/05/2019 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe auditueve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

Kontrata e shërbimit

Kontrata e shërbimit nr. 5074 prot. Datë 01.06.2019, me objekt “Kryerja e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore në mënyre ligjore, të paanshme, transparente dhe profesionale si dhe cdo detyrim tjetër I parashikuar në këtë kontratë, në përputhje me Kodin

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



Zgjedhor, ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike", I ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, dhe aktet nenligjore të KQZ të miratuara për këtë qëllim

i. Vendimi i KQZ-së

Vendimi i KQZ-së nr. 740, datë 31.05.2019-: Per shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë, të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

ii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar për fushatën zgjedhore, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

-Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



-Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera

-Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të raportimit financiar për fushatën zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

c. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

“Partia Ardhmëria Shqiptare”, është regjistruar pranë Gjykatës me Vendimin Nr. 1171, datë 03/03/2005, dhe nr. 4566 datë 15/11/2002.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”.

Qëllimi dhe objektivat e Partisë pasqyrohen qartë në programin e Statutit të saj.

Organet me të larta drejtuese të partisë janë:

1. Kongresi i Partisë
2. Këshilli Drejtues
3. Konsulta e Partisë
4. Departamenti i Garancive Statutore

Kryetari i partisë është Z. Emin SUBASHI

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe deget rajonale)

“Partia Ardhmëria Shqiptare” ka selinë në Tiranë, nuk ka dege nëpër rrethe

d. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Informacion për Subjektin Zgjedhor, Pasqyra financiare dhe Deklarata.

2/a Të ardhura- Fonde Publike

2/b Të ardhura jopublike monetare

2/c Të ardhura jopublike në natyrë

2/d Të ardhura jopublike të krijuara

3. Të ardhura – Huatë

4/a Shpenzimet

4/b Shpenzimet për mitingje, të hartuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8580, datë 17/02/2000 “Për Partitë politike” I ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10/02/2011, ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22/05/2017

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundshme midis audituesit ligjor dhe subjektit zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Pas lidhjes së kontratës me KQZ, për monitorimin e fushatës dhe Auditimin e fushates zgjedhore, eksperti financiar ka kontaktuar me Kryetarin e Partisë Ardhmëria Shqiptare Z.Emin Subashi.

Mbas nënshkrimit të kontratës së shërbimit me KQZ u pajisa me të dhëna të subjektit zgjedhor Partia “Partia Ardhmeria Shqiptare”. Sipas regjistrimit rezultoi se subjekti zgjedhor, Partia “Partia Ardhmeria Shqiptare” është me adresë: Rruga „Idriz Dollapi“, pall nr.23, Shkalla nr.2 Ap nr.30 me Kryetar Z.Emin Subashi, sekretar Organizativ Zj. Sherife Molla

Me marrjen e të dhënave ne kontaktuam në telefon në datë 02/06/2019 me drejtuesit e subjektit zgjedhor, “Partia Ardhmeria Shqiptare” Z. Emin Subashi (Kryetar) për ti informuar në lidhje me shërbimin që ne do të kryenim sipas kontratës me KQZ dhe njëkohësisht për të marrë informacionin e nevojshëm për aktivitetet e subjektit zgjedhor, zyrat elektorale, etj., për të filluar procesin e monitorimit dhe auditimit. Takimin me përfaqësuesit e subjektit zgjedhor e realizuam në datë 03/06/2019. Në takim ne i informuam përfaqësuesit e subjektit zgjedhor në lidhje me shërbimin që do të kryenim dhe kërkuam në mënyrë jo formale të njihemi me aktivitetet e subjektit zgjedhor partisë “Partia Ardhmeria Shqiptare” për fushatën zgjedhore 2019 dhe vendodhjen e zyrave elektorale si dhe gjithë dokumentacionin per auditimin e fushates.

iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit

“Partia Ardhmeria Shqiptare” ka përgatitur raportin e financimit të fushatës zgjedhore të cilin e ka dorezuar pranë KQZ në datë 26/09/2019. Raporti nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8580, datë17/02/2000 “Për Partitë politike” I ndryshuar me ligjin nr.10374, datë10/02/2011, ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22/05/2017



II. KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit		
a) dorëzim në formë elektronike	Po / Jo	Datë
b) dorëzim fizik	Po	26/09/2019
2/ Nënshkrimi		
Nënshkrimi	Po	25/09/2019
3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës		
a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po / Jo	Datë 04/10/2019
b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po / Jo	
c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Sherife Molla

B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

- A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?

- Llogaria bankare e subjektit zgjedhor është hapur në datë 04/10/2019, llogaria është hapur jashtë afateve ligjore, nga procesi i auditimit, nuk kemi konstatuar donacione baraz dhe mbi 100,000 Lekë.
- Nuk ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet.
- Nuk ka raste të llogarive bankare “të fjetura” që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme

Miratur me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019

Raporti i financimit

Plotesia e informacionit

- Evidenca e çeljes së llogarisë bankare – kontrate celje llogarie bankare date 04/10/2019.
- Nuk ka dokumentacion i lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore eshte per veprimet bankare te periudhes 01/05/2019 – 29/08/2019 (pasi data e celjes se llogarise bankare eshte 04/10/2019).

b/ Personi përgjegjës për Financën

Identiteti i personit përgjegjës për financën:

Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partisë, është znj. Sherife Molla, vullnetare.

- Personi përgjegjës për financat është Sekretare Organizative e Partise. Duke konsideruar buxhetin shume te vogel dhe veprimet e pakta financiare, nuk e cmojme si problem, konflikt interesi, kete fakt
- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:
 - Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore është bere nga kryetari i partise Z. Emin Subashi.
 - Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		<i>Të Ardhurat</i>		
			Financime publike	162,500
			Donacione private	111,500
			Financim nga burimet e veta të partisë	0
			Huatë/Kreditë	0
		<i>Shpenzimet</i>		
		Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	0	

		Materialet promovuese	0
		Media	0
		Sondazhe të Opinionit Publik	0
		Botime	0
		Transporti	185,000
		Konsulenca	
		Reklamime në ambiente të hapura	
		Administrative dhe të përgjithshme	89,000

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e pagesës paradhënie	0	0
	Data e tranfertës	n/a	n/a
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve	162,500	162,500
	Data e transfertës	08/10/2019	08/10/2019
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka	0	0
	Data e transfertës	n/a	n/a

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	111,500	111,500
	Shuma e donacioneve në para	111,500	111,500
	Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
	Përgatitet një listë e donatorëve		po
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		n/a
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		Vlerat e donacioneve janë me te vogla se 100,000 lekë. Nuk janë bërë nëpërmjet llogarisë bankare
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		n/a
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		n/a
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		n/a
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		po
	Respektimi i kufirit të donacionit		po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	0	0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	0	0
	<i>Botimet</i>	0	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0	0
	<i>Marrje me qera</i>	0	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	0	0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	0	0
	<i>Botimet</i>	0	0

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



<i>Shtypshkronja</i>	0	0
<i>Marrje me qera</i>	0	0
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)		n/a
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		n/a
4/ Huatë/Kreditë		
Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	0	0
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		n/a
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Jo	Donacionet janë në vlerë më të vogël se 100,000 lekë, nuk janë ërë nëpërmjet llogarisë bankare

IV. ANALIZA

a/Financimi Publik

“Partia Ardhmeria Shqiptare” ka terhequr fondet publike te paracaktuara ne shumen 162,500 leke.

Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi. “Partia Ardhmeria Shqiptare” deklaroi se nuk e ka përdorur kohën e lire te transmetimit, nuk ka bere reklama, publikime per qellime te fushates zgjedhore. Ne rastet kur mediat kane transmetuar ndonje interviste apo informacione per Partinë Ardhmeria Shqiptare, keto kane qene me iniciativen e vete medias perkatese, dhe jo me qellim publiciteti nga kjo parti.

Raste abuzimi, keqpërdorimi të burimeve publike nuk është evidentuar, as edhe në raportin e monitorimit.

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**

- Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar:

Financimi nga burimet jo publike (shuma totale 111,500 leke) është kryer nga donatore persona fizike të ligjshme

- Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë:

Shuma e përgjithshme e donacioneve, prej 111,500 leke, është bërë nga persona të ndryshme, jo nga i njëjti donator. Kjo shumë nuk e kalon kufirin prej 1,000,000 leke për një donator. Partia Ardhmëria Shqiptare nuk ka degë, pra financimi është bërë në nivel qendror.

Burimet e palejuara – nuk ka

Kontributet në natyrë – nuk ka

○ **Kufizimet**

Vlera totale e shpenzuar për fushatën zgjedhore, prej 274,000 leke, është shumë e ulët në krahasim me kufirin maksimal të shpenzimeve të lejuara të fushatës zgjedhore, si dhe me kufirin maksimal të financimit nga 1 donator i vetëm. Pra nuk ka shkelje të këtyre kufizimeve.

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**

- Kuotat e anëtarësisë: nuk ka
- Shtypshkronjat- nuk ka
- Marrja me qera – nuk ka

- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**

- Zyrat Qendrore- nuk ka
- Degët locale-nuk ka

- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi “nxjerrje e llogarisë”)**

Nuk është e aplikueshme

d/ Huatë/Kreditë

- Identiteti i huadhënësit/ve- nuk ka

- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë) –nuk ka
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira– në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)- nuk ka
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)-nuk ka

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar	274,000					
Respektimi i kufirit të shpenzimit	Po					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë						
Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës						
Materialet promovuese						
Media						
Sondazhet e opinionit publik						
Botimet						
Transporti						
Konsulenca						
Reklamat në ambientet e jashtme						

Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese							
Media							
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamat në ambientet e jashtme							
Administrative dhe të përgjithshme							
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Jo



B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve: - është respektuar kufiri i shpenzimeve maksimale të fushatës zgjedhore
b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës ;**
 - o Pagesa për vendin;
 - o Shpenzimet e zbavitjes;
 - o Shpenzimet e pajisjeve; o Shpenzimet për pijet;
 - o Shpenzimet e dekorit/vizuale;
 - o Shpenzimet e Transportit;
 - o Shpenzimet e Administratës
- **Materialet promovuese**
- **Media**
- **Sondazhet e opinionit publik**
- **Botimet**
- **Transporti.....185,000 lekë**
- **Konsulenca**
- **Reklammat në ambientet e jashtme**
- **Administrative dhe të përgjithshme...89,000 lekë**

KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;
- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- Shpenzimeve që janë bërë para fillimit të fushatës zgjedhore (që nga 5 Dhjetori e më pas) duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.
- *Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.*



V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

o Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019 të Partisë Ardhmëria Shqiptare, kanë një vlerë totale prej 274,000 lekesh, e cila konsiderohet mjaft e ulët në krahasim me shpenzimet maksimale të lejuara të kësaj fushate zgjedhore. Anëtarët e Partisë Ardhmëria Shqiptare kanë kontribuar si individë në fushatën zgjedhore, dhe nuk kanë patur kontribut në natyrë. Nuk kanë mosperputhje apo shkelje të kufizimeve bazuar në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore respektive.

• Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit –

Gjatë auditimit u konstatua:

- 1. Format i Raportimit nuk është në përputhje me përputhje me kërkesat e ligjit nr.8580, datë 17/02/2000 "Për Partitë politike" I ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10/02/2011, ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22/05/2017*
- 2. Mungon dokumentacioni ligjor për shpenzimet e kryera gjatë fushatës.*

• Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiar

Në raportin e monitorimit të ekspertit financiar nuk janë konstatuar shkelje të rregulloreve apo ligjeve.

B. PËRFUNDIMI


Opinionin me rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyra e deklarimeve financiare paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, fondet e arkëtuara dhe të shpenzuara gjatë fushatës elektorale 2019 në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8580, datë 17/02/2000 "Për Partitë Politike" I ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10/02/2011, ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22/05/2017

Baza për opinionin me rezerve

- 1. Format i Raportimit nuk është në përputhje me përputhje me kërkesat e ligjit nr.8580, datë 17/02/2000 "Për Partitë politike" I ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10/02/2011, ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22/05/2017*

Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019



2. Mungon dokumentacioni ligjor për shpenzimet e kryera në shumën 274,000 lekë gjatë fushatës.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Auditues Ligjor

Tirane me 16/12/2019

Anita Pulaj



Miratuar me Vendimin Nr.152 datë 11.04.2019

